

PROCES VERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Hartimi i Projektit të Detajuar dhe Ndërtimi i Bazës Mekanike për Mirëmbajtjen e Trenave (DEPO) Durrës - Tiranë - Rinas”,

Punë ndërtimi - 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,019,477,360.9 Leke pa tvsh. (Një miliard e nëntëmbëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë pikë nëntë)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 (ndryshuar me ligjin nr.16/2024, datë 08.02.2024) “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) autoriteti/enti kontraktor ”Hekurudha Shqiptare sh.a” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 79, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik *(ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është e bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin, 43 pika 2 gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021(ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024) “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve financiare të tre viteve të fundit dhe verifikimin e aktivitetit pozitiv të qëndrueshëm është vendosur me qëllim vlerësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për të provuar se operatori ekonomik ka stabilitet financiar, aftësi për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga kontrata dhe vijimësi në ushtrimin e aktivitetit të tij ekonomik. Analiza e bilanceve për disa vite radhazi mundëson vlerësimin e gjendjes reale financiare të subjektit dhe minimizon rrezikun e lidhjes së kontratës me operatorë që paraqesin vështirësi financiare ose që mund të mos jenë në gjendje të realizojnë kontratën sipas kushteve të kërkuara.

Kushti që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon aktive të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e tij dhe paraqet qëndrueshmëri financiare.

Ndërsa kërkesa për Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar është parashikuar vetëm për subjektet që, sipas legjislacionit në fuqi, kanë detyrimin ligjor për auditimin e pasqyrave financiare. Kjo kërkesë synon të garantojë besueshmërinë, saktësinë dhe transparencën e të dhënave financiare të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

2.3 Kapaciteti teknik :

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së fondit limit , të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet konkretisht 2,038,954,722 lekë pa tvsh (dy miliard e tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë katërmijë e shtatëqind e njëzetë e dy).

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët

ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- *Kontratë Sipërmarrje;*
 - *Situacionin përfundimtar;*
 - *Aktin e kolaudimit*
 - *Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);*
 - *Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.*
 - *Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore*

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- *Kontratë Sipërmarrje*
 - *Situacionin përfundimtar;*
 - *Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.*
 - *Leje ndertimi*
 - *Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- *Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.*
- *Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 2,3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është

kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa për paraqitjen e përvojës së mëparshme të ngjashme synon të verifikojë kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përcaktimi i alternativës së parë, që operatori ekonomik të ketë realizuar të paktën një kontratë të vetme me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit, garanton se ofertuesi ka përvojë në menaxhimin dhe realizimin e punimeve me kompleksitet, volum dhe vlerë të krahasueshme me kontratën që prokurohet.

Ndërsa alternativa e dytë, që operatori ekonomik të ketë realizuar disa kontrata të ngjashme me vlerë totale jo më të vogël se dyfishi i fondit limit gjatë pesë viteve të fundit, synon të mundësojë pjesëmarrjen edhe të operatorëve që kanë realizuar me sukses një numër më të madh kontratash, të cilat së bashku dëshmojnë kapacitet dhe eksperiencë të mjaftueshme profesionale.

Parashikimi që mjafton plotësimi i njërit prej dy alternativave siguron respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe nxit konkurrencën, duke u dhënë mundësi pjesëmarrjeje një numri më të gjerë operatorësh ekonomikë.

Dokumentacioni i kërkuar (kontrata, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit, certifikatat e marrjes në dorëzim, faturat tatimore dhe formularët e vlerësimit) është i nevojshëm për të provuar jo vetëm ekzistencën e kontratave, por edhe realizimin e tyre me sukses, vlerën reale të punimeve të kryera, afatet e zbatimit dhe natyrën e punimeve, duke i mundësuar autoritetit kontraktor një vlerësim objektiv të përvojës së operatorit ekonomik.

Kërkesat e veçanta për kontratat e realizuara në bashkim operatorësh ose si nënkontraktor synojnë të evidentojnë pjesën konkrete të punimeve të realizuara nga secili operator ekonomik dhe të shmangin mbështetjen në përvoja që nuk lidhen drejtpërdrejt me kontributin e tij real në kontratat e mëparshme.

2.3.2. Licenca dhe certifikime profesionale të Kompanive Projektuese dhe stafit.

Subjektet Projektuese, pjesëmarrëse kërkohen të zotërojnë, Liçensa në Projektim, referuar

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në

vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për liçensimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Për ofertuesit e huaj, në zbatim të dispozitave ligjore më sipër, duhet të kenë të ekuivalentuar licensën sipas liçensimit të Legjislacionit Shqiptar.

1. PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

b-3. Vepra arti ne infrastrukture , tombino, kanale kullues etj.

Argumentim:

Projekti perfshin:

- Godina teknike funksionale per hyrjen/dajen e trenave me hapësira per personel, per pajisjet e sinjalizimit, telekomunikim, etj, hapësira per ndenjen e punonjesve te levizjes, shërbime sanitare per meshkuj dhe per femra.
- Objekte civile ndihmese dhe objekte industriale, (Reparte), ne shërbim te funksionimit te Depotit.
- Nderhyrje ne infastrukture ne nivelin kombetar, per te cilat kerkohe zgjdhje arkitektonike per nderlidhje me teritorin dhe funksionimin njerezor.

b- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

Kërkesa për disponimin e liçencës në kategorinë “a” justifikohet nga fakti se objekti i prokurimit përfshin projektimin e një Baze Mekanike për Mirëmbajtjen e Trenave (DEPO), e cila klasifikohet si objekt industrial me funksione të specializuara teknike dhe operative.

Projektimi arkitekturor është i domosdoshëm për organizimin funksional të ndërtesave të depo-s, ambienteve të mirëmbajtjes së trenave, hapësirave administrative, ambienteve të personelit, zonave teknike dhe ndihmëse, duke garantuar respektimin e standardeve të sigurisë, funksionalitetit, ergonomisë dhe integritetit me infrastrukturën hekurudhore ekzistuese dhe atë të planifikuar.

Për më tepër, objekti mund të përfshijë ambiente shërbimi, administrimi dhe mbështetjeje teknike, të cilat kërkojnë zgjidhje të plota arkitekturore në përputhje me legjislacionin urbanistik dhe normat teknike të projektimit.

b-3. Vepra arti ne infrastrukture , tombino, kanale kullues etj.

Kërkesa për liçencën në kategorinë b-3 justifikohet nga nevoja për projektimin e veprave inxhinierike ndihmëse që lidhen me funksionimin e kompleksit hekurudhor dhe të zonës së depo-s. Ndërtimi i bazës së mirëmbajtjes së trenave kërkon projektimin e sistemeve të drenazhimit dhe largimit të ujërave sipërfaqësore, kanaleve kulluese, tombinove dhe strukturave të tjera hidroteknike për të garantuar mbrojtjen e objektit nga përmbytjet, grumbullimi i ujërave dhe dëmtimi i infrastrukturës hekurudhore.

Gjithashtu, në varësi të konfigurimit të terrenit dhe zgjidhjeve teknike të projektit, mund të nevojiten vepra arti të vogla infrastrukturore, kalime teknike, tombino ose struktura të ngjashme që sigurojnë funksionimin normal të rrjetit të brendshëm rrugor, hekurudhor dhe të sistemeve të kullimit. Prandaj, disponimi i kësaj licence garanton që operatori ekonomik ka kapacitetet profesionale dhe teknike për të projektuar të gjitha elementet infrastrukturore të nevojshme për realizimin e objektit në përputhje me standardet inxhinierike dhe kërkesat e sigurisë.

2. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

Argumentim:

Projekti përfshin:

- Godine teknike funksionale, objekte civile – industriale, te ndertuara me strukture beton – arme ose metalike qe kerkon licencen “a”

Projekti struktural per objekte ndertimi, ligjerisht, cdo objekt teknik – industrial, kerkon zgjidhje konstruktive te firmosur nga inxhinier i licensuar.

Kërkesa për disponimin e licencës së projektimit në kategorinë “Projektues Konstruktor – a” justifikohet nga natyra e objektit të prokurimit, i cili përfshin projektimin dhe ndërtimin e një Baze Mekanike për Mirëmbajtjen e Trenave (DEPO), e përbërë nga ndërtesa dhe struktura me funksione industriale dhe mbështetëse.

Objekti përfshin ambiente të mirëmbajtjes së trenave, godina teknike, magazina, ambiente administrative, ambiente për personelin dhe struktura të tjera ndihmëse, të cilat kërkojnë hartimin e projektit konstruktiv për elementët mbajtës të ndërtimit, duke garantuar qëndrueshmërinë, sigurinë dhe jetëgjatësinë e veprës.

Projektuesi konstruktor është i nevojshëm për dimensionimin dhe verifikimin e strukturave prej betoni të armuar dhe murature, për llogaritjen e ngarkesave statike dhe dinamike, si dhe për garantimin e përputhshmërisë së projektit me normat teknike të projektimit dhe standardet e sigurisë në fuqi.

Duke qenë se objekti përfshin ndërtime me karakter industrial dhe infrastrukturë mbështetëse të lidhur me funksionimin e depo-s hekurudhore, prania e këtij specialiteti garanton hartimin e zgjidhjeve konstruktive të sigurta dhe funksionale, të afta për të përballuar ngarkesat operative dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit gjatë gjithë ciklit të tij të jetës.

3. PROJEKTUES INSTALATOR

c. Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile dhe industriale

d. Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacionit dhe te sinjalizimit hekurudhor.

f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

g. Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

- i. *Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive, etj*
- j. *Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., pwr objektet civile e industrial*

Argumentim:

c. Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile dhe industriale

Projekti perfshin:

- Ndertesa teknike dhe industrial, ndricim te godines teknike, si dhe lidhjen me rrjetin kombetar.

Kerkohet projekt i plote elektrik i brendshem dhe i jashtem, duke zbatuar standartet e sigurise elektrike, tensioneve, mbrojtjes dhe dimensionimeve.

d. Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacionit dhe te sinjalizimit hekurudhor.

Projekti perfshin :

- Sisteme te brendeshme dhe te jashtme te sinjalizimit, transmetim te dhenash, kontroll te levizjes trenave dhe rrjete optike/internet per komunikim operacional.
- Pavec aspektit te sigurise sistemi i kontrollit te trenave, duhet te jete i projektuar nga profesionist i licensuar me d, per te permbushur standartet e EN.

f. Projektim te sistemeve kundra zjarrit

Projektimi i sistemeve te mbrojtjes nga zjarri, dedektore, sprinkles, pom[pa zjarrfikese, rrjete uji dhe garazh inerte, eshte detyrim ligjor per cdo objekt publik logjistik dhe tekbollogjik. Sipas vkm 943 dhe akteve per mbrojtjen nga zjarri projekti teknik per sistemin kundra zjarrit kerkon instalator te licensuar ne “f”

g. Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa.

Godina e levizjes trenave kerkon sisteme automatike te sinjalizimit hekurudhor, menaxhim energjie, telekomnande per rrjetet elektrike dhe ndricim qe jane elemente kyc per funksionimin e saj. Kerkon projektim te automateve industriale dhe protokolleve te kontrollit si SCADA nga projektuesi qe ka licencen “g”

i. Projektim te ndricimit rrugor, shesheve, ndricimit te objekteve etj

- Rruga hyrese tek Baza Mekanike, linja hekurudhore, rruga perimetrale dhe sheshi i shtrirjes se Bazes Mekanike, duhet te ndricohen sipas standarteve te ndricimit publik dhe te sigurise per hekurudhat, rruget auto dhe llogjistike. Kerkohet projektues me eksperience dhe licence per ndricim profesional licenca ‘ i ‘

j. Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, sistemet e alarmit, access controll, sistemet e dedektimit te zjarrit per objektet civile dhe industriale.

Ne godinen e levizjes se trenave, ne repartet e reja si dhe gjate linjes hekurudhore nevojiten te instalohen rrjete te integruara per CCTV dhe sigurine, Access Control, sisteme alarmi dhe dedektim zjarri, sinjalizim akustik dhe vizual. Kerkohet projektues profesionist me licence “j” qe sherben per funksionimin dhe mbrojtjen e jetes ne ambientet teknike.

4. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b. Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.*
- c. Ujësjetës-kanalizime urbane – rurale.*
- d. Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha)*

Argumentim:

b. Furnizim me uje – kolektore shkarkimi.

Projekti perfshin ndertimin e strukturave, godina kontrollit, reparteve pune, te cilet kerkojne furnizim te dedikuar me uje (sanitar, teknik, zjarrfikes si dhe rrjet te evakuimit te ujerave te ndotura dhe te shiut, nepermjet kolektoreve shkarkues. Ky projektim konsiderohet pjese e rrjeteve ingjnerike urbane dhe kerkon projektues te licensuar ne ‘b ‘, per te siguruar perputhshmerine me standartet per dimensionimin, prurjen , presionin dhe siguri hidraulike.

c. Ujesjelles – kanalizimi urbane – rurale.

Teritori i ndertimit te objektit eshte pjese e nje zone e cila eshte ne rritje dhe zhvillohet. Per kete qellim linjat e ujesjellesit dhe kanalizimeve duhet te projektohen dhe te integrohen per tu lidhur me rrjetin ekzistues ose te parashikuar sipas planeve zhvillimore vendore. Rrjetet duhet te merren ne dorezim nga Operatoret Publik te ujesjelles – knalizime, çka ligjerisht kerkon projektim nga profesioniste te licensuar me liçence ‘ c ‘.

Projektimin dhe miratimi i ketyre rrjeteve nga AKUM apo Bashkia, nuk pranohet pa firme profesionale te licensuar ne kete kategorie.

d. Vepra ujitjeje – kullimi – impiante vaditese, damba, sifona, priza, tombino etj.

Territori ku shtrihet Baza Mekanike, ndodhet ne nje zone me nivel te larte ujrash, me rrezik permytjesh si dhe eshte perbytur disa here. Nga ana e krahut te zones se plazhit, ndodhet nje kanal kullues i madh i mbyllur. Jane ose mund te jene te nevojshme, tombino/priza uji, kanale drenazhuese, rrjedhe e kontrolluar te ujrave siperfaqesore. Keto vepra klasifikohen si infrastrukture hidroteknike e rregulluar me vkm 943 dhe kerkojne projektim te dosdoshem nga profesionist te licensuar me license ‘ d ‘

5. PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA

- a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.*
- e- Hekurudha – degezime hekurudhore.*

Argumentim:

a. Rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

Projekti perfshin permision te aksesit rrugor ne brendesi te Bazes Mekanike dhe lidhjen me rrjetin hekurudhor te linjes Durres Tirane. Do te ndertohen rruge dytesore ndihmese hyrje/dalje per automjete dhe rruge industriale te brendeshme per funksionimin llogjistik dhe nderlidhes ndermjet tyre. Projektim i ketyre rrugeve te ketij niveli perben objekt te veprave te infastruktues rrugore dhe kryhet nga licensues me kategori ne "a"

e. Hekurudha – degezime hekurudhore.

Objekti kryesor i projektit e ndertimi i nje degezimi te ri hekurudhor, realizimin e nje standarti hekurudhor. qe perfshin :

- Ndertimin e nenshtresave
- Ndertimin e superstruktures hekurudhore me ballast dhe pa ballast, shina, traversa, ndruese hekurudhore etj , sipas standartit tip te ndertimit te superstruktures hekurudhore, ne degezime hekurudhore.-
- Kalime ne nivel (nqse do te kete)

Projekti parashikon lidhjen hekurudhore te degezimit me rrjetin hekurudhor kombetar, nepermjetnje ndërruese , qe ndodhen ne linjen nr.3 te stacionit hekurudhor Shkozet.

Projekti per shtrirjen e linjes hekurudhore duhet te perfshije :

- Trasene e linjes hekurudhore
- Profilin gjatesor dhe terthor
- Seksionin terthor sipas standartit hekurudhor tip te degezimit hekurudhor.
- Vendosja e elementeve te sigurise, sinjalistike etj
- Parashikimin per vendosjen e sistemit te sinjalizimit si dhe te elektrifikimit.

Projektimi i linjave hekurudhore, ne cdo shtrirje dhe tipollogji, kerkon patjeter licensim te kategorise " e ".

6. PROJEKTUES GJEODET

a- Rivelime inxhinierike.

b- Rilevime inxhinierike kadastrale.

e.- Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Argumentim:

a. Rilevime inxhinierike

Projekti perfshin ndertimin e nje degezimi hekurudhor dhe te objekteve ndertimore civile – industriale dhe rrugore, qe kerkon :

- Matje topografike te detajuara te terrenit ekzistues.

- Ndertimin e rrjetit te pikave referuese gjeodezike
- Trasimin e sakte te trasese hekurudhore, kthesave, si dhe te zones se ndertimit te objekteve civile – industriale. Ky aktivitet hyn ne fushen e rilevimeve inxhinierike, qe sipas vkm nr.943 kerkon licence ‘a ‘ .

b. Rilevime inxhinierike kadastrale

Zona e projektit perfshin toke publike industriale dhe toke private, per te cilen :

- Duhet te percaktohen kufijte ligjore dhe teknike te projektit.
- Te behet pasqyrimi i pasurive ne terren
- Te pergatiten matejalet per legalizim, shpronesim, kalim pronesie.

Ky aktivitet klasifikohet si relevim inxhinieriko – kadastral dhe kerkon licence “b”

e. Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Per projektimin e degezimit hekurudhor dhe te objekteve ndertimore si edhe per qellime dokumentimi dhe integriteti ne GIS :

- Kerkohet harte topografike dhe ortofoto e zones per miratim, planifikim dhe menaxhim pasuror.
- Mund te perdoret dron me kamera me precizion te larte per krijimin e modeleve 3D te terrenit dhe volumetrike.

Projektimi dhe perpunime fotogrametrik i ketyre materjaleve eshte veprimtari e licensuar ne kategorine “e”, dhe kerkon perdorim te teknologjise te certifikuar dhe softuereve te specializuar.

Rezultatet nga kjo veprimtari sherbejne si baze per projektimin e infrastruktures se degezimit dhe te objekteve , per integrimin e projektit ne sistemet dixhitale si dhe per monitorimin ne kohe reale te progresit te punimeve ne fazen e zbatimit.

7. STUDIM GJEOLGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLGJIK

- a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.*
- e.- Studime e projekte hidrogjeologjike.*

Argumentim:

a. Studim/gjeollogo – inxhinierik i truallit per objekte civile – ekonomike deri ne 5 kate.

Projekti perfshin ndertimin e objekteve teknike reparte, objekte nje kateshe dhe trase hekurudhore.

Keto objekte per te garantuar sigurine strukturore, kerkojne vleresim te kapacitetit mbajtjes dhe karakteristikave te truallit te themelit. Sipas vkm nr.943, cdo nderhyrje ndertimore mbi toke per objekte ndertimi deri ne 5 katekerkon patjeter studim te tokes.

e. Studim e projekte hidrogjellogjike

Projekti kalon ne zone me nivel te larte ujrash nentokesore, kanale kullimi dhe terren qe permbytet. sezonalisht. Per kete qellim eshte e dosdoshme te vleresohet perhapja e ujrave nentokesore, ndikimi i ndertimit ne shtresat ujembajtese, nevoja per drenazhe dhe mbrojtja ndaj ngritjes se ujrave. Sipas Vkm kjo veprimtari, kerkon license specifike ‘ e ‘ per projektim/studim hidrollogjik.

8. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

c- Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.

e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

Argumentim:

c. Impiante te prodhimit te energjise elektrike te rinovueshme diellore.

e.Kabina elektrike te rrjetit shperndares -linja tensionit te ulet – te mesem.

Projekti parashikon vendosjen e paneleve diellore ne mbulesat e Repartit te Riparimit automatriceve si dhe nje rrjet elektrik ne te gjithë Repartet si dhe ne ndertimet e objekteve te tjera.

Keto licenca kërkohen për projektimin e sistemeve të furnizimit dhe menaxhimit të energjisë elektrike në kompleksin e DEPO-s hekurudhore, duke përfshirë si kabinat elektrike dhe rrjetet e tensionit të ulët e të mesëm, ashtu edhe sistemet e mundshme të energjisë së rinovueshme (p.sh. fotovoltaike). Këto elemente janë thelbësore për garantimin e furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas me energji elektrike për godinat, pajisjet industriale dhe sistemet teknologjike të objektit.

9. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

d-sinjalistike ndricuese ne infrastrukture.

Argumentim:

a. Sinjale jondriçuese në rrugë lokale, urbane dytësore, interurbane dytësore, sheshe dhe parkime

Kjo kërkesë justifikohet nga fakti se projekti përfshin ndërtimin e rrugëve automobilistike të brendshme brenda territorit të Bazës Mekanike, si dhe lidhjen e tyre me rrjetin rrugor ekzistues jashtë objektit. Sinjalistika jondriçuese është e domosdoshme për organizimin e qarkullimit, orientimin e mjeteve, përcaktimin e prioriteteve të lëvizjes dhe garantimin e sigurisë së përdoruesve brenda kompleksit industrial dhe në nyjet e lidhjes me rrugët dytësore publike.

d. Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë

Kjo licencë kërkohet për projektimin e sinjalistikës ndriçuese në rrugët e brendshme të Bazës Mekanike dhe në lidhjet e saj me rrugët ekzistuese. Duke qenë se objekti do të funksionojë edhe në orare nate ose në kushte me shikueshmëri të kufizuar, ndriçimi dhe sinjalistika ndriçuese janë thelbësore për sigurinë e qarkullimit, orientimin e mjeteve dhe minimizimin e riskut të aksidenteve brenda zonës industriale dhe në akseset hyrëse/dalëse të saj.

10. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

a. - Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

b. - Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

Argumentim:

a. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve

b. Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore

Këto kërkesa justifikohen nga natyra e projektit, i cili parashikon ndërtimin e objekteve industriale (reparte pune dhe struktura teknike), si dhe ndërtesa mbështetëse sociale dhe administrative brenda Bazës Mekanike për Mirëmbajtjen e Trenave.

Duke qenë se këto struktura kanë funksion industrial dhe përfshijnë ngarkesa të konsiderueshme operative dhe teknologjike, është e domosdoshme kryerja e studimeve të detajuara gjeologo-sizmike dhe sizmologjike inxhinierike për përcaktimin e karakteristikave të truallit dhe klasifikimit gjeosizmik të tij. Këto studime shërbejnë si bazë për projektimin e themeleve dhe strukturave mbajtëse, duke garantuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe sjelljen e duhur të objektit në kushte sizmike.

Operatori ekonomik duhet të garantojë projektimin në përputhje me parametrat sizmikë të territorit, duke minimizuar rreziqet strukturore dhe duke siguruar përmbushjen e standardeve teknike të ndërtimit në fuqi.

Këto kërkesa janë në përputhje me:

- Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020;
- Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020;
- VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.

Këto akte ligjore përcaktojnë detyrimin për respektimin e kushteve gjeoteknike dhe sizmike në projektim dhe ndërtim, duke e bërë të domosdoshme kryerjen e studimeve përkatëse për garantimin e sigurisë strukturore të objekteve.

Individët apo personat juridik të cilët disponojnë licenca të cilat nuk janë në përputhje me pikat e Lidhjes 2 “Kategorite në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, të V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre. Në rastin e mosparaqitjes së licencave, ofertuesit nuk do të merren në konsideratë për kualifikim. Licencat duhet të jenë të paraqitura dhe të plotësohen nga licenca e subjektit si dhe të gjitha pikat e sipërpërmendura të cilat jepen edhe për individë duhet të përmbushen nga shumatorja e pikave të licencave individuale të stafit inxhinierik.

Pikat e licencave apo certifikimeve që nuk trajtohen në V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016 duhet të jenë në përputhje me V.K.M. Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (Qkl) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta”, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe

lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, V.K.M. Nr. 407 date 19.06.2019 “Për Miratimin e Procedurës, to Kategorive, Kushteve, Kërkesave to Kualifikimit dhe te Eksperiencës Profesionale për Personin, te Cilit i Lëshohet Certifikata e Audituesit Energjetik” dhe akteve nënligjore në fuqi.

2.3.3 Staf i kërkuar :

Operatori ekonomik ose bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të ketë të përfshirë si drejtues teknik dhe të figurojë në Licensën e shoqërisë, stafin e mëposhtëm:

- | | |
|---|---------|
| - Projektues Arkitekt | 1 (një) |
| - Projektues Strukturist | 1 (një) |
| - Projektues Infrastruktura | 1 (një) |
| - Projektues Depoti | 1 (një) |
| - Projektues Mekanik | 1 (një) |
| - Projektues Elektrik | 1 (një) |
| - Projektues Sistem Sinjalizim Hekurudhor | 1 (një) |
| - Projektues Gjeodet | 1 (një) |
| - Projektues Gjeolog | 1 (një) |
| - Projektues Hidroteknik | 1 (një) |

Për stafin e mësipërm duhet paraqitur për secilin dokumentacioni provues si:

- Diploma
- CV personale
- Kontrata e Punës (e vlefshme ligjërisht)
- Secili nga anëtarët e stafit të sipërcituar dhe të angazhuar, të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve për t’u realizuar objekt i kësaj kontratë në rast të shpalljes fitues.
- Staf i sipërcituar të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për ekspertët e huaj ose ekspertët e specializuar vendas, të cilët nuk përfshihen në kategoritë e licencimit sipas legjislacionit shqiptar, operatori ekonomik provon disponueshmërinë e tyre nëpërmjet kontratës së punës, kontratës së bashkëpunimit, marrëveshjes së angazhimit, deklaratës së disponueshmërisë ose çdo dokumenti tjetër ligjor ekuivalent.

Për këta ekspertë nuk kërkohet figurimi në licencën profesionale të operatorit ekonomik dhe as në listëpagesat e tij.

Kualifikimet profesionale të ekspertëve të huaj vërtetohen me diploma, licenca profesionale, certifikata ose dokumente ekuivalente të lëshuara nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës, të shoqëruara me përkthim zyrtar në gjuhën shqipe. Per sa i perket eksperteve te huaj referencat e paraqitura duhet te jene te firmosura e vulosura nga klienti shoqeruar me kontaktet e tij.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentim:

- Ligji nr. 107/2014, i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”;
- VKM nr. 943, datë 28.12.2016, për kriteret dhe procedurat e licencimit të profesionistëve në fushën e zhvillimit të territorit;
- Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 1, shkronja “a”, kërkon që operatorët të demonstrojnë kapacitet teknik dhe profesional të mjaftueshëm.

Kërkesa për disponimin e stafit teknik të specializuar, si drejtues teknik dhe pjesë e licencës së shoqërisë, justifikohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit “Hartimi i Projektit të Detajuar dhe Ndërtimi i Bazës Mekanike për Mirëmbajtjen e Trenave (DEPO) Durrës – Tiranë – Rinas”, i cili përfshin një gamë të gjerë disiplinash inxhinierike dhe ndërhyrjesh infrastrukturore.

Përfshirja e projektuesve të specializuar në fusha të ndryshme siguron mbulimin e plotë të të gjitha komponentëve të projektit, si arkitekturë, struktura, infrastruktura rrugore, instalime mekanike dhe elektrike, sisteme hekurudhore, si dhe studime gjeoteknike dhe hidroteknike. Secili profil profesional është i domosdoshëm për të garantuar zgjidhje të integruara, të sigurta dhe në përputhje me standardet teknike dhe ligjore në fuqi.

Kërkesa që stafi të figurojë në licencën e shoqërisë dhe në listëpagesat e fundit siguron që operatori ekonomik ka kapacitet real organizativ dhe profesional, si dhe disponueshmëri të menjëhershme të burimeve njerëzore për realizimin e kontratës. Kjo minimizon rrezikun e angazhimit të stafit vetëm në mënyrë formale dhe garanton vazhdimësinë e punimeve dhe përgjegjësinë profesionale gjatë zbatimit të projektit.

Dokumentacioni i kërkuar (diploma, CV, kontrata pune dhe deklarata disponueshmërie) shërben për të verifikuar kualifikimin profesional, përvojën dhe angazhimin real të secilit specialist në projekt.

Për ekspertët e huaj ose të specializuar, pranimi i dokumenteve ekuivalente dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit justifikohet nga nevoja për fleksibilitet në sigurimin e ekspertizës së avancuar teknike, duke garantuar njëkohësisht respektimin e standardeve ndërkombëtare të projektimit.

Ky kriter është gjithashtu në përputhje me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), duke siguruar që verifikimi i plotë i dokumentacionit të bëhet në fazën përpara shpalljes së fituesit, në funksion të rritjes së transparencës dhe efektivitetit të procedurës së prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, konkretisht:

- *Specialist Vleresimit Mjedisit* 1 (një)
- *Ekonomist* 1 (një)

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim:

Kërkesa për disponimin e stafit mbështetës, konkretisht Specialist për Vlerësimin e Mjedisit dhe Ekonomist, justifikohet nga natyra shumëdisiplinore e objektit të kontratës dhe nevoja për menaxhim të plotë teknik, mjedisor dhe financiar gjatë realizimit të projektit.

Përfshirja e Specialistit të Vlerësimit të Mjedisit është e domosdoshme për garantimin e respektimit të kërkesave ligjore dhe teknike në fushën e mbrojtjes së mjedisit, identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore të punimeve ndërtimore, si dhe për hartimin dhe zbatimin e masave zbutëse gjatë fazës së projektimit dhe ndërtimit. Duke qenë se objekti përfshin ndërhyrje infrastrukturore dhe industriale, menaxhimi i ndikimit mjedisor është pjesë integrale e zbatimit të kontratës.

Përfshirja e Ekonomistit është e nevojshme për ndjekjen dhe kontrollin e aspekteve financiare dhe administrative të projektit, përfshirë menaxhimin e kostove, raportimin financiar dhe mbështetjen e procesit të zbatimit të kontratës në përputhje me buxhetin e miratuar dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. Kjo siguron transparencë dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike.

Kërkesa që ky staf të vërtetohet me kontratë pune, diplomë përkatëse dhe vetëdeklarim, shërben për të garantuar disponueshmërinë reale dhe kualifikimin profesional të tyre gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

Në përputhje me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), verifikimi i dokumentacionit përkatës bëhet në fazën përpara shpalljes së fituesit, duke siguruar një proces më efikas, transparent dhe të kontrolluar të vlerësimit të ofertave.

2.3.5 Numri minimal i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave (e Vërtetuar kjo me listë pagesat përkatëse, të Konfirmuar nga Drejtoria e Taimëve, sipas formularit E-Sig 02/a.)

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim:

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 10 punonjës të siguruar për muajin e fundit para hapjes së ofertave justifikohet nga nevoja për të garantuar kapacitetin minimal organizativ dhe operacional të nevojshëm për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Duke qenë se projekti përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh inxhinierike dhe ndërtimore me natyrë komplekse, është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë një strukturë bazë punonjësish të formalizuar dhe të angazhuar realisht në aktivitet, për të siguruar vazhdimësinë e punimeve, menaxhimin efektiv të detyrave dhe përmbushjen në kohë të objektivave të kontratës.

Ky kriter shërben gjithashtu për të verifikuar stabilitetin e operatorit ekonomik dhe për të shmangur subjektet me kapacitet të kufizuar ose pa strukturë reale organizative, të cilat mund të rrezikojnë zbatimin e kontratës.

Vërtetimi i këtij kushti përmes listëpagesave të konfirmuara nga administrata tatimore (formulari E-Sig 02/a) siguron objektivitet, transparencë dhe verifikim të saktë të punonjësve të deklaruar.

Në përputhje me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), dokumentacioni provues kërkohet në fazën përpara shpalljes së fituesit, duke garantuar një proces më efikas dhe të kontrolluar të vlerësimit të ofertave.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prova të certifikimit nga organe të pavarura akredituese si më poshtë:

ISO 22163:2023 Sistemi i menaxhimit të Cilësisë Hekurudhore (IRIS)

ISO 9001:2015 Sistemi Manaxhimit të Cilësisë (QMS)

ISO 14001:2015 Sistemi Manaxhimit Mjedisor (EMS)

ISO 45001:2018 Sistemet e menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (OH&S)

ISO 50001:2018 Sistemet e menaxhimit të energjisë (EnMS)

Certifikatat e sipercituara ose ekuivalente të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim:

Kërkesa për paraqitjen e certifikimeve ISO nga operatorët ekonomikë justifikohet nga natyra komplekse dhe strategjike e objektit të prokurimit, i cili përfshin projektim dhe ndërtim të një baze mekanike hekurudhore me standarde të larta teknike, sigurie dhe operimi. Këto certifikime shërbejnë për të garantuar se operatori ekonomik disponon sisteme të konsoliduara menaxhimi në fusha kyçe të cilësisë, mjedisit, sigurisë, energjisë dhe specifikisht sektorit hekurudhor.

ISO 22163:2023 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë hekurudhore (IRIS)

Kjo certifikatë është thelbësore për projekte në sektorin hekurudhor, pasi garanton që operatori ekonomik zbaton standarde të specializuara për industrinë hekurudhore, duke përfshirë sigurinë, cilësinë e proceseve dhe besueshmërinë operationale. Ajo siguron që projektimi dhe ndërtimi të jenë në përputhje me kërkesat specifike teknike të këtij sektori kritik.

ISO 9001:2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë (QMS)

Kjo certifikatë garanton ekzistencën e një sistemi të strukturuar të menaxhimit të cilësisë, duke siguruar standardizim të proceseve, kontroll të vazhdueshëm të cilësisë dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve. Ajo është një garanci për realizimin e punimeve në përputhje me standardet e kërkuara kontraktuale.

ISO 14001:2015 – Sistemi i menaxhimit mjedisor (EMS)

Kjo kërkesë është e domosdoshme për të siguruar që operatori ekonomik identifikon, menaxhon dhe minimizon ndikimet mjedisore gjatë projektimit dhe ndërtimit të objektit. Duke qenë se projekti përfshin ndërhyrje infrastrukturore dhe industriale, respektimi i standardeve mjedisore është thelbësor për zhvillim të qëndrueshëm.

ISO 45001:2018 – Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (OH&S)

Kjo certifikatë garanton që operatori ekonomik ka të implementuar sisteme efektive për menaxhimin e rreziqeve në punë, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve gjatë fazës së projektimit dhe ndërtimit, duke minimizuar aksidentet dhe incidentet në punë.

ISO 50001:2018 – Sistemi i menaxhimit të energjisë (EnMS)

Kjo certifikatë justifikohet nga nevoja për menaxhim efikas të energjisë gjatë realizimit dhe funksionimit të objektit. Ajo siguron që operatori ekonomik ka kapacitet për të optimizuar përdorimin e energjisë dhe për të implementuar zgjidhje efikase energjetike, gjë veçanërisht e rëndësishme për një objekt me karakter industrial dhe hekurudhor.

Në tërësi, kërkesa për këto certifikime ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organe të akredituara synon të garantojë standarde të larta profesionalizmi, cilësie, sigurie dhe qëndrueshmërie në realizimin e kontratës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e projektit.

2.3.7 Licenca dhe certifikime profesionale të Kompanive Zbatuese dhe stafit.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

N.P.-1 Punime germimi ne toke

N.P.-2 Ndertime civile dhe industriale

N.P.-4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

N.P.-7 Ujesjelles gaz sjelles, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje

N.P.-10 Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike

N.P.-11. Ndertime per n/stacionet, kabima te transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjes se energjiise.

N.P.-12 Punime te inxhinierise se Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

N.S.-1 Punime per prishjen e ndertimeve

N.S.- 2 Impiante hidro - sanitare

N.S.- 4 Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materjal plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese

N.S.-5 Impiante te sinjalistikes ndicuese te trafikut.

N.S.- 6 Sinjalistika rrugore jo ndricuese

N.S.- 8 Punime Parafabrikat beton-arme, struktura metalike dhe druri.

N.S.-11 Punime mbi shina dhe traversa

N.S.-12 Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit

N.S.-13 Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikimi

N.S.-14 Impiante te brendeshme elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

N.S.-16 Ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij

N.S.-18 Punime topogjeodezike

N.S.-20 Shpime gjeologo – inxhinierike, puse e shpime per uje.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentim:

Kërkesa për disponimin e licencës profesionale të shoqërisë dhe përfshirjen e kategorive të përcaktuara sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008, të ndryshuar, justifikohet nga natyra shumë komplekse dhe multidisiplinare e objektit “Hartimi i Projektit të Detajuar dhe Ndërtimi i Bazës Mekanike për Mirëmbajtjen e Trenave (DEPO) Durrës – Tiranë – Rinas”, i cili përfshin një gamë të gjerë punimesh civile, industriale, infrastrukturore dhe hekurudhore.

Këto kategori licence garantojnë që operatori ekonomik ka kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale për të realizuar të gjitha komponentët e projektit në përputhje me standardet kombëtare të ndërtimit dhe kërkesat e sigurisë.

Kategoritë e punimeve dhe justifikimi:

N.P.-1 – Punime gjurmimi në tokë

Kjo kategori kërkohet për realizimin e punimeve fillestare të terrenit, përgatitjen e platformave ndërtimore dhe sistemit të zonës së ndërtimit të DEPO-s hekurudhore.

N.P.-2 – Ndërtime civile dhe industriale

Është kategoria bazë për ndërtimin e godinave të bazës mekanike, përfshirë ambiente industriale, administrative dhe mbështetëse të operimit hekurudhor.

N.P.-4 – Rrugë, hekurudha dhe infrastrukturë transporti

Justifikohet nga ndërtimi i rrugëve të brendshme, lidhjeve me rrjetin ekzistues dhe elementeve hekurudhore brenda kompleksit të DEPO-s.

N.P.-7 – Ujësjellës, kanalizime dhe vepra kullimi

Kërkohet për sistemet e furnizimit me ujë, kanalizimet dhe drenazhimin e zonës industriale, të domosdoshme për funksionimin normal të objektit.

N.P.-10 – Ndërtimi i impianteve të energjisë elektrike

Nevojitet për realizimin e sistemeve energjetike që furnizojnë objektin, përfshirë instalime të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë.

N.P.-11 – Nënstacione dhe linja të energjisë elektrike

Justifikohet nga nevoja për kabina elektrike, linja të tensionit të ulët dhe të mesëm për furnizimin e të gjithë kompleksit industrial.

N.P.-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit

Kërkohet për menaxhimin e ndikimeve mjedisore, trajtimin e ujërave dhe garantimin e standardeve të mbrojtjes së mjedisit.

Punime speciale ndërtimi:

N.S.-1 – Punime për prishjen e ndërtimeve

Nevojitet për pastrimin e terrenit dhe heqjen e strukturave ekzistuese përpara fillimit të ndërtimit.

N.S.-2 – Impiante hidro-sanitare

Kërkohet për instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve në godinat e DEPO-s.

N.S.-4 – Punime rifiniture dhe elemente teknike ndërtimi

Justifikohet nga nevoja për përfundimin e godinave industriale dhe administrative me standarde teknike të larta.

N.S.-5 dhe N.S.-6 – Sinjalistikë ndriçuese dhe jo ndriçuese

Të domosdoshme për organizimin e qarkullimit rrugor dhe hekurudhor brenda dhe jashtë kompleksit.

N.S.-8 – Struktura metalike dhe parafabrikat

Kritike për ndërtimin e hangarëve dhe strukturave industriale të mirëmbajtjes së trenave.

N.S.-11 – Punime mbi shina dhe traversa

Direkt e lidhur me funksionin hekurudhor të objektit dhe ndërtimin e infrastrukturës së trasesë brenda DEPO-s.

N.S.-12 – Impiante teknologjike, termike dhe kondicionimi

Kërkohet për sistemet HVAC dhe instalimet teknologjike të ambienteve industriale.

N.S.-13 – Impiante telefonike dhe telekomunikacioni

Nevojitet për sistemet e komunikimit dhe kontrollit operacional të bazës.

N.S.-14 – Impiante të brendshme elektrike dhe sisteme sigurie

Kritike për funksionimin e sistemeve elektrike, CCTV, alarmit dhe kontrollit të aksesit.

N.S.-16 – Impiante të ujit të pijshëm dhe trajtimit

Justifikohet nga nevoja për furnizim dhe trajtim të ujit në kompleks.

N.S.-18 – Punime topogjeodezike

E domosdoshme për matjet, kontrollin e terrenit dhe saktësinë e realizimit të projektit.

N.S.-20 – Shpime gjeologo-inxhinierike

Kërkohet për studimet e terrenit dhe verifikimin e kushteve gjeoteknike të ndërtimit.

Për operatorët e huaj

Kërkesa për ekuivalentimin e licencave profesionale të huaja pranë Ministrisë përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë justifikohet nga nevoja për garantimin e barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomikë, verifikimin e përputhshmërisë së standardeve profesionale dhe sigurimin e një niveli të njëjtë kualifikimi për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

Mosparaqitja e licencave në formën e kërkuar përbën kusht skualifikues, pasi pengon verifikimin objektiv të kapaciteteve profesionale dhe ligjore të operatorit ekonomik në përputhje me VKM nr. 42/2008 të ndryshuar.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

			Profili
1	Inginier strukturist	1 (nje)	Ing. Ndertimi, Strukturist
2	Inxhinier mekanik	1 (nje)	Ing. Mekanik, Impiante etj
3	Inxhinier elektrik	1 (nje)	Ing Elektrik per automatizim apo Industrie
4	Inxhiner infrastrukture/transporti	1 (nje)	Ing. Ndertimi ne Infastrukture Transporti
5	Inxhinier gjeodet	1 (nje)	Ing. Gjeodet topograf, markshajder, gjeomatik
6	Inxhinier gjeoteknik	1 (nje)	Ing. Gjeologji inginierike/hidrogjellogji/gjeoteknik
7	Inginier Sinjalizimit hekurudhor	1 (nje)	Ing. Inxhinier elektrik per sistemi sinjalizim hekurudhor

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesipërme, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Për këtë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-kontratë individuale pune të vlefshme,

-diplomë përkatëse,

-librezë pune

-si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri. Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentim:

AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme

që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Kërkesa për disponimin e personelit kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë, justifikohet nga natyra e specializuar dhe multidisiplinare e objektit të kontratës, i cili përfshin projektim dhe ndërtim të një baze mekanike hekurudhore me komponentë civilë, industriale, infrastrukturorë dhe teknologjikë.

Përfshirja e një ekipi drejtues teknik me profile të ndryshme inxhinierike është e domosdoshme për të garantuar koordinimin teknik të punimeve, cilësinë e zbatimit dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit dhe ndërtimit.

Inxhinier strukturist

Nevojitet për projektimin dhe kontrollin e strukturave mbajtëse të godinave industriale dhe teknike, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objekteve nën ngarkesa statike dhe dinamike.

Inxhinier mekanik

Është i domosdoshëm për projektimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve mekanike, pajisjeve industriale dhe instalimeve të lidhura me funksionimin e bazës së mirëmbajtjes së trenave.

Inxhinier elektrik

Kërkohet për projektimin dhe kontrollin e sistemeve elektrike, automatizimit industrial dhe furnizimit energjetik të kompleksit, duke garantuar siguri dhe funksionim të qëndrueshëm.

Inxhinier infrastrukture/transporti

Nevojitet për projektimin dhe koordinimin e rrugëve të brendshme, lidhjeve infrastrukturore dhe komponentëve të transportit brenda dhe jashtë zonës së DEPO-s hekurudhore.

Inxhinier gjeodet

Është i domosdoshëm për matjet topografike, kontrollin gjeodezik dhe saktësinë e vendosjes së elementeve të projektit në terren.

Inxhinier gjeoteknik

Kërkohet për analizën e kushteve të tokës, stabilitetit të terrenit dhe projektimin e themeleve të strukturave, duke garantuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e ndërtimit.

Inxhinier i sinjalizimit hekurudhor

Është i nevojshëm për projektimin dhe kontrollin e sistemeve të sinjalizimit hekurudhor, komunikimit dhe sigurisë operative të lëvizjes së trenave brenda dhe jashtë kompleksit.

Në tërësi, ky ekip drejtues teknik siguron mbulimin e plotë të disiplinave kryesore të projektit dhe garanton një menaxhim teknik të integruar, të koordinuar dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë, cilësisë dhe standardeve të zbatimit të veprave infrastrukturore hekurudhore.

Shenim: Bazuar ne Rekomandimin Nr.6732, date 21.10.2020” Mbi problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”, inxhinierët e mësipërm duhet te vetdeklarojne se ata jane te disponueshem për realizimin e kësaj kontrate

2.3.9 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, konkretisht:

1. Specialist Depoti (EMU)
2. Specialist i sigurise ne pune
3. Specialist mjedisor
4. Specialist i licensuar per saldimin e shinave

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.8 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim:

Kërkesa për disponimin e stafit mbështetës nga operatori ekonomik justifikohet nga natyra e specializuar dhe operacionale e objektit të kontratës, i cili përfshin ndërtimin dhe funksionimin

e një baze mekanike hekurudhore me procese teknike të ndërlikuara, kërkesa të larta sigurie dhe standarde të rrepta mjedisore dhe industriale.

Specialist Depoti (EMU)

Ky profil është i domosdoshëm për shkak të natyrës së veçantë të objektit, i cili përfshin ndërtimin dhe operimin e një baze mekanike për mirëmbajtjen e trenave elektrikë (EMU). Specialisti garanton organizimin dhe kontrollin teknik të proceseve të mirëmbajtjes, diagnostikimit dhe operimit të mjeteve hekurudhore elektrike, si dhe siguron që infrastruktura e depove të funksionojë sipas standardeve teknike dhe operacionale të kërkuara në sektorin hekurudhor.

Specialist i sigurisë në punë

Ky specialist është i nevojshëm për garantimin e zbatimit të rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë gjatë gjithë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të objektit. Duke qenë se projekti përfshin punime me rrezik të lartë (punime ndërtimi, instalime elektrike, mekanike dhe hekurudhore), roli i tij është thelbësor për identifikimin e rreziqeve, parandalimin e aksidenteve dhe sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin për sigurinë në punë.

Specialist mjedisor

Kjo kërkesë justifikohet nga nevoja për menaxhimin e ndikimeve mjedisore që mund të shkaktohen gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës mekanike. Specialisti mjedisor siguron zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit, monitorimin e ndotjes së mundshme (ajër, tokë, ujë), menaxhimin e mbetjeve dhe respektimin e kërkesave ligjore dhe standardeve mjedisore në fuqi.

Specialist i licencuar për saldimin e shinave

Ky profil është kritik për sigurinë dhe integritetin e infrastrukturës hekurudhore, pasi saldimi i shinave përbën një proces teknik shumë të ndjeshëm që ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin dhe funksionimin e linjave hekurudhore. Specialisti i licencuar garanton që punimet e saldimit të realizohen sipas standardeve të kërkuara teknike, duke minimizuar rrezikun e defekteve strukturore dhe duke siguruar jetëgjatësinë dhe sigurinë e infrastrukturës hekurudhore.

Kërkesa që stafi i përfshirë në këtë pikë të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera ose i deklaruar në procedura të tjera fituese synon të garantojë disponueshmërinë reale dhe efektive të burimeve njerëzore gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke shmangur mbivendosjen e angazhimeve dhe rrezikun e mosrealizimit të detyrimeve kontraktuale.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, detyrimi për ndarjen e stafit në përputhje me përqindjen ose natyrën e pjesëmarrjes siguron proporcionalitet, ndarje të drejtë të përgjegjësisë dhe mbulim të plotë të nevojave të projektit nga secili anëtar i bashkimit.

Verifikimi përmes formularit të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit përkatës, në përputhje me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), garanton transparencë dhe kontroll të plotë të kapaciteteve njerëzore të deklaruara nga operatorët ekonomikë.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 45 (dyzet e pese) persona. në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet.

Stafi i sipërcituar të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ë fuqi (nëpërmjet formës elektronike). Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentim:

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimalisht 45 punonjës të siguruar justifikohet nga natyra e punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë një gamë të gjerë aktiviteteve inxhinierike, ndërtimore, instalimesh teknologjike dhe punimesh hekurudhore me intensitet të lartë.

Ky numër minimal i fuqisë punëtore garanton kapacitetin operativ të nevojshëm për realizimin paralel të disa proceseve ndërtimore, duke siguruar vijueshmëri të punimeve, respektim të afateve kontraktuale dhe organizim efikas të kantierit. Duke qenë se projekti përfshin struktura industriale, infrastrukture dhe sisteme teknike të specializuara, kërkohet një staf i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha fazat e zbatimit, nga punimet civile deri te instalimet teknologjike.

Vërtetimi i këtij kriteri përmes listëpagesave të muajit të fundit shërben për të garantuar që fuqia punëtore e deklaruar është reale, aktive dhe e angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në aktivitetin e operatorit ekonomik, duke shmangur deklaratimet formale ose jo reale.

Ky kriter kontribuon gjithashtu në rritjen e besueshmërisë së operatorit ekonomik dhe në sigurimin e një niveli minimal organizativ të nevojshëm për menaxhimin e një projekti me kompleksitet të lartë teknik dhe volum të konsiderueshëm pune.

Në përputhje me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), dokumentacioni provues kërkohet të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, duke garantuar transparencë dhe verifikim objektiv të kapaciteteve të deklaruara.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Makineri Paisje per Ndertimin e Linjave hekurudhore

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1	Makineri ose Pajisje per saldimin e shinave.	Pronësi ose me qira	1 cope
2	Pajisje portative per mberthimin e shinave me traversen e betonit.	Pronësi ose me qira	1 cope
3	Pajisje per prerjen e shinave	Pronësi ose me qira	1 cope
4	Kamjon vete shkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Pronësi ose me qira	1 cope

5	Fadrome me kapacitet mbi 2 m3 per ngarkim materjalesh	Pronësi ose me qira	1 cope
6	Krik Autovinc 10-20 ton per ngritjen e linjes hekurudhore	Pronësi ose me qira	1 cope
7	Paisje portative vobro tokamk per rrafjen e cakullit nen traverse..	Pronësi ose me qira	1 cope
8	Eskavator me zinxhire 0.25 m3- 1 m3 per demolimin e reparteve, per germim plinta, themele, bazamente	Pronësi ose me qira	1 cope
9	Eskavatore me goma mbi 0.5 m3	Pronësi ose me qira	1 cope

Makineri Paisje per NdertiminObjekteve

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1	Ekskavatorë	Pronësi ose me qira	1cope
2	Buldozerë	Pronësi ose me qira	1 cope
3	Grejderë	Pronësi ose me qira	1 cope
4	Ngarkues frontalë	Pronësi ose me qira	1 cope
5	Kamionë vetëshkarkues	Pronësi ose me qira	1 cope
6	Betoniere industriale	Pronësi ose me qira	1 cope
7	Pompa betoni	Pronësi ose me qira	1cope
8	Vinça kullë ose vinça mobilë	Pronësi ose me qira	1 cope
9	Kompresorë industrialë	Pronësi ose me qira	1 cope
10	Makineri për asfaltim dhe ngjeshje toke	Pronësi ose me qira	1 cope
11	Vibrator betoni siperfaqesore	Pronësi ose me qira	1 cope
12	Vibrator betoni thellsie	Pronësi ose me qira	1 cope
13	Skela inventar mbi 1500 m ²	Pronësi ose me qira	1 cope
14	Autobitumatrice	Pronësi ose me qira	1 cope

15	Asfalto shtruese	Pronësi ose me qira	1 cope
16	Rrul per shtresat asfaltike, me vibrator me dy cilindra hekur hekur copë 1 mbi 5 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
17	Rrul per nëneshtrusat, me vibrator Gome hekur mbi 18 ton	Pronësi ose me qira	1 cope
18	Grejder	Pronësi ose me qira	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- *Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.*
- *Per mjetet e marra me qira qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Per te gjithë mjetet dhe paisjet e kerkuara te shoqerohen me foto.*

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim:

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të listuara në këtë pikë justifikohet nga kompleksiteti i lartë teknik i objektit të kontratës, i cili përfshin njëkohësisht ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore, realizimin e objekteve civile dhe industriale, si dhe instalimin e sistemeve teknologjike të specializuara. Për realizimin e suksesshëm të punimeve është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë kapacitet të plotë mekanik dhe logjistik për të garantuar cilësi, siguri dhe respektim të afateve.

Pajisje për ndërtimin e linjave hekurudhore

Makineritë e specializuara për punime hekurudhore si pajisjet për saldimin e shinave, pajisjet për mbërthimin e shinave me traversa, pajisjet për prerjen e shinave dhe pajisjet për rrafshimin e

çakëllit janë thelbësore për realizimin teknik korrekt të linjës hekurudhore. Ato garantojnë integritetin strukturor të trasesë, saktësinë e montimit dhe sigurinë operationale të sistemit hekurudhor.

Mjete si krikët, autovinçat, ekskavatorët dhe kamionët vetëshkarkues sigurojnë manipulimin, ngritjen dhe transportin e materialeve të rënda, si dhe realizimin e punimeve të gërmimit, montimit dhe sistemimit të infrastrukturës hekurudhore.

Pajisje për ndërtimin e objekteve civile dhe industriale

Pajisjet e ndërtimit si ekskavatorët, buldozerët, grejderët, ngarkuesit frontalë, betoniere industriale dhe pompat e betonit janë të domosdoshme për realizimin e strukturave civile dhe industriale të bazës mekanike. Ato mundësojnë kryerjen e punimeve të gërmimit, transportit të materialeve, prodhimit dhe vendosjes së betonit, si dhe ndërtimin e elementeve strukturore me volum të madh pune.

Vinçat kullë ose mobilë, kompresorët industrialë dhe skelat janë të nevojshme për montimin e strukturave të larta, realizimin e rifiniturave dhe sigurimin e kushteve teknike për punime në lartësi.

Pajisjet për asfaltim dhe ngjeshje, rrolat vibrues, autobitumatricet dhe asfaltoshtueset sigurojnë ndërtimin e rrugëve të brendshme dhe sipërfaqeve operative, duke garantuar cilësi të lartë të shtresave rrugore dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Vibratorët e betonit dhe pajisjet ndihmëse janë të domosdoshme për realizimin e betonimeve me cilësi strukturore të garantuar, duke shmangur defektet teknike në elementët mbajtës.

Argumentim për fleksibilitetin e pronësisë

Lejimi i përdorimit të mjeteve në pronësi ose me qira siguron fleksibilitet dhe konkurrencë të drejtë në procedurë, duke u mundësuar operatorëve ekonomikë të marrin pjesë edhe nëse nuk disponojnë të gjithë flotën e pajisjeve në pronësi, por duke garantuar njëkohësisht disponueshmërinë reale të tyre gjatë ekzekutimit të kontratës.

Dokumentacioni provues

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit përkatës (leje qarkullimi, certifikata teknike, siguracion, kontrata qiraje, aktet e pronësisë dhe fotot e mjeteve) synon të garantojë verifikimin objektiv të ekzistencës, funksionalitetit dhe gatishmërisë së mjeteve të deklaruara, duke shmangur deklaratimet formale dhe duke rritur besueshmërinë e operatorëve ekonomikë.

Përputhshmëria me vetëdeklarimin

Parashikimi që kriteri të përmbushet përmes formularit të vetëdeklarimit në fazën fillestare, në përputhje me VKM nr. 285/2021 (i ndryshuar), siguron thjeshtim të procedurës së vlerësimit, ndërsa dokumentacioni i plotë verifikohet para nënshkrimit të kontratës, duke garantuar transparencë dhe kontroll efektiv të kapaciteteve reale të operatorit ekonomik.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtnuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Shënim: Në çdo kerkese të preventivit ku është shënuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”

Argumentim:

Kërkesa për përcaktimin e Drejtnuesit Teknik të punimeve nga operatori ekonomik justifikohet nga nevoja për sigurimin e një menaxhimi të unifikuar teknik dhe profesional të të gjithë procesit të zbatimit të kontratës. Duke qenë se objekti përfshin punime komplekse infrastrukturore, hekurudhore, civile dhe industriale, është thelbësore që të ketë një figurë të vetme përgjegjëse për koordinimin teknik, kontrollin e cilësisë dhe garantimin e përputhshmërisë me projektin dhe standardet në fuqi.

Kërkesa që Drejtnuesi Teknik të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera synon të sigurojë disponueshmërinë reale dhe të plotë të tij gjatë gjithë kohëzgjatjes së punimeve. Prania e tij e vazhdueshme në kantier është thelbësore për vendimmarrjen teknike në kohë reale, zgjidhjen e problematikave gjatë zbatimit dhe garantimin e cilësisë së punimeve.

Dokumentacioni shoqërues (kontrata e punës dhe diploma) shërben për të vërtetuar kualifikimin profesional dhe marrëdhënien e punësimit, duke garantuar që personi i propozuar ka aftësitë dhe statusin ligjor të nevojshëm për ushtrimin e funksionit të Drejtnuesit Teknik.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomikë, detyrimi për përcaktimin e Drejtnuesit Teknik nga secili anëtar, në përputhje me pjesëmarrjen e tij në kontratë, synon të sigurojë ndarje të qartë të përgjegjësisë, mbulim të plotë të të gjitha komponentëve të projektit dhe koordinim efektiv ndërmjet palëve. Kjo qasje garanton që çdo pjesë e punimeve të ketë mbikëqyrje teknike të dedikuara dhe të kualifikuara.

Verifikimi përmes formularit të vetëdeklarimit, në përputhje me nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285/2021 (i ndryshuar), siguron një proces të thjeshtuar në fazën fillestare të vlerësimit, ndërsa

kontrolli i dokumentacionit përkatës kryhet përpara lidhjes së kontratës, duke garantuar transparencë dhe besueshmëri në përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

Shtimi i termit “ekuivalente e saj” në kërkesat e preventivit siguron hapje të garës dhe shmang kufizimin në marka specifike, duke lejuar përdorimin e materialeve me standarde të njëjta ose më të larta cilësore.